



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Këshilli i Legjislacionit

PROCESVERBAL

Tiranë, më 24.05.2019, ora 12:30

Drejton mbledhjen: Bashkim Fino – Kryetar i Këshillit

Rendi i ditës:

- 1- Njohjen e Këshillit të Legjislacionit me anëtarët e rinj;
- 2- Caktimin e relatorëve.
- 3- Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Bashkim Fino, Alket Hyseni, Ermonela Felaj, Klotilda Bushka, Rudina Hajdari,
Aurora Mara, Fatjona Dhimitri

Mungojnë:

Adnor Shameti

Bashkim Fino - Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen!

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Legjislacionit, fillojmë mbledhjen e këtij këshilli.

Në rendin e ditës së sotme kemi këto çështje:

- 1- Njohjen e Këshillit të Legjislacionit me anëtarët e rinj;
- 2- Caktimin e relatorëve.
- 3- Çështje të tjera.

Sjell në vëmendjen tuaj se në dosjet që keni përpara do të gjeni të gjitha materialet e nevojshme, të cilat krijojnë një panoramë mbi veprimtarinë e deritanishme të Këshillit të Legjislacionit.

Gjithashtu, stafi i Kuvendit ju ka përcjellë në rrugë elektronike materialet e nevojshme.

Në fillim, për arsye të shkëputjes për një kohë të gjatë nga mbledhja e fundit e këtij këshilli (27 shkurt 2018), po ju njoh me urdhrin e Kryetarit të Kuvendit për emërimin e 3 anëtarëve të rinj në këtë këshill. Me urdhrin nr. 1, datë 8.05.2019 të Kryetarit të Kuvendit anëtarët e rinj të Këshillit të Legjislacionit nga Grupi Parlamentar Demokrat dhe nga Grupi Parlamentar i Pavarur janë zonjat: Rudina Hajdari, Fatjona Dhimitri dhe Aurora Mara.

Përbërja e Këshillit të Legjislacionit sipas parashikimeve të nenit 14 të Rregullores së Kuvendit, do të jetë me 10 anëtarë (5 anëtarë deputetë të grupit parlamentar të maxhorancës dhe 5 anëtarë të grupeve parlamentare të opozitës).

Siç thashë, me urdhrin nr. 1, datë 8.05.2019 të Kryetarit të Kuvendit janë emëruar 3 anëtarë të rinj, që janë prezent dhe u urojmë mirëseardhjen, sipas propozimeve të paraqitura nga grupet parlamentare. Është detyrë e grupeve parlamentare të opozitës, në rastin konkret, tuajin, të propozohen edhe dy anëtarë të tjerë të rinj në përbërje të këtij këshilli për të pasur raportin 5 me 5 në Këshill. Për të siguruar përfaqësim të barabartë ndërmjet shumicës parlamentare, drejtimi i Këshillit të Legjislacionit, sipas nenit 14 të Rregullores së Kuvendit, bëhet me rotacion çdo 5 muaj nga secili anëtar, duke filluar sipas renditjes alfabetike të mbiemrit të anëtarëve. Sipas këtij rotacioni që nga mesi i janarit, për 5 muaj këtë këshill kam nderin ta drejtoj unë. Shpresoj t'i mbarojmë të gjitha çështjet nën drejtimin tim, që të mos i lëmë gjë Klodit apo kujtdo tjetër, që do të vijë në drejtim pas meje.

Këshilli i Legjislacionit pas botimit të vendimit nr. 34, datë 10.4.2017, vendimit nr. 41, datë 16.5.2017 dhe vendimit nr. 78, datë 12.12.2017, ka marrë në shqyrtim dhe ka diskutuar për problematikën që shkaktojnë shfuqizimet e disa neneve në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr.

115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Pas prezantimit në mënyrë të përmbledhur të vendimeve të GJK-së nga sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe nga diskutimi i anëtarëve të këtij këshilli në mbledhjet e zhvilluara nga data 19 janar 2018 deri më 7 shkurt 2019, Këshilli vendosi të thërrasë ekspertët ligjorë sipas propozimit të deputetëve të maxhorancës dhe atyre të opozitës në të për draftimin e riformulimeve të dispozitave të shfuqizuara nga Gjykata Kushtetuese.

Ekspertët kanë sjellë propozimet e tyre për të dyja projektligjet, që ju i keni në dosje tashmë (projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”” dhe projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë””).

Për të dyja këto projektligje janë dakordësuar mes ekspertëve me përjashtim të disa neneve, të cilat janë sjellë në dy versionet, që ju i keni në dosjet tuaja, ku secili grup ekspertësh ka mbajtur qëndrimin e vet. Në mbledhjen e Këshillit të Legjislacionit të datës 27.2.2018 u la detyrë që dy projektligjet të studiohen nga deputetë për t’u diskutuar në mbledhjen e ardhshme, pra në mbledhjen e sotme.

Sot përbërja e Këshillit të Legjislacionit ka ndryshuar. Janë ngritur dhe po funksionojnë edhe KLP-ja, edhe KLGJ-ja, edhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, që janë institucione që zbatojnë ndër të tjera ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Gjithashtu, në këtë fazë është i nevojshëm edhe mendimi i ekspertëve të misionit EURALIUS dhe të misioneve të tjera ndërkombëtare, të cilat kanë asistuar në vijimësi procesin e reformës në drejtësi. Për këtë arsye kërkoj mendimin e anëtarëve të Këshillit për caktimin e relatorëve dhe caktimit të kalendarit për vijimin e punës së Këshillit.

Gjithashtu, ju bëj me dije se anëtarët e rinj kanë të drejtë të kërkojnë dhe të caktojnë ekspertët e tyre për këtë këshill dhe për të marrë vendimin përkatës.

Së fundi, kemi miratimin e procesverbalin e mbledhjes së datës 27.2018.

Jeni dakord me procesverbalin e mbledhjes së datës 27.2018?

Dakord.

Miratohet.

E hapa mbledhjen, duke u uruar mirëseardhjen 3 anëtarëve të rinj. Ju keni të drejtë t’i propozoni Kryetarit të Kuvendit edhe 2 anëtarë të tjerë, të cilët me vendim të Kryetarit të Kuvendit e plotësojnë Këshillin e Legjislacionit në raportin 5 anëtarë nga maxhoranca dhe

5 anëtarë nga opozita për të siguruar përfaqësim të barabartë ndërmjet shumicës parlamentare dhe opozitës.

Kuorumi për të bërë mbledhjen e sotme është i mjaftueshëm. Po veprojmë shumë drejt që po e zhvillojmë atë.

Në dosje keni relacionin që ka bërë sekretari i Përgjithshëm për të 2 projektligjet që ka kthyer GJK-ja për disa nene të caktuara. Ndërkohë, në mbledhjen e mëparshme të Këshillit (unë kam qenë anëtar i tij), ne kemi caktuar ekspertët tanë, si grupim i maxhorancës dhe ekspertët që kanë qenë nga grupimi i opozitës, të cilët na kanë sjellë opinionet, që i keni përpara. Në përgjithësi, janë dakordësuar me përjashtim të disa neneve që përsëri i keni përpara në dy variante: në variantin e ekspertit tonë dhe në variantin e ekspertit të opozitës.

Që të mos vazhdojmë me këta ekspertë për të dyja projektligjet, meqë është ndryshuar përbërja e Këshillit të Legjislacionit, ju takon juve si opozitë të caktoni një ekspert tuajin. Nëse nuk e keni të gatshëm sot, na e dërgoni zyrtarisht në Këshillin e Legjislacionit brenda këtyre ditëve për të bashkëpunuar me ekspertin tonë (ne e kemi të konfirmuar ekspertin tonë) për t'i riparë edhe një herë këto dy projektligje, të cilat janë kthyer mbrapsh për disa nene të caktuara nga GJK-ja. Mbasi ekspertët e të dyja palëve të bëjnë një draft përfundimtar (shpresojmë të bien në një mendim të përbashkët të dy ekspertët), dy draftet do të paraqiten në mbledhjen e radhës së Këshillit të Legjislacionit me një mendim të përbashkët, që të kalojnë më tej në Komisionin e Ligjeve për t'u diskutuar në mënyrë të detajuar.

Pra, ky është objekti i diskutimit të mbledhjes së sotme të Këshillit të Legjislacionit.

Faleminderit!

Fjala për ju!

Alket Hyseni - Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, ju uroj suksese në drejtimin e Këshillit të Legjislacionit për këtë periudhë që ju jeni në drejtimin e tij. Ne jemi të bindur se ky do të jetë një drejtim i suksesshëm dhe unë uroj të kemi fatin t'i miratojmë këto procedura për t'i përcjellë në Komisionin e Ligjeve dhe në Kuvend.

Njëkohësisht, u uroj mirëseardhjen dhe suksese tre anëtarëve të rinj të nderuar të Këshillit.

Ne, anëtarët e maxhorancës mendojmë që relatore nga pala jonë për këto projektligje të jetë zonja Bushka, sepse është e involvuar dhe e njeh këtë proces. Besoj se një

nga zonjat që do të jetë nga pala e opozitës, të operojë sa më shpejt, pasi edhe pse është kryer ekspertiza, mund të ketë nevojë për një ekspertizë ekstra.

Kisha një sugjerim: meqë tani organet janë krijuar si për shembull KLP-ja që involvohet drejtpërdrejt këtu, të merret një ekspertizë apo të bëhet një konsultë edhe me ta, sepse me aq sa kanë filluar nga puna, ata mund të japin këshilla të vlefshme. Njëkohësisht, edhe ekspertët apo relatorët mund të kenë nevojë të marrin mendimin e tyre.

Faleminderit!

Bashkim Fino - Faleminderit!

Jam absolutisht dakord me ju. Unë e thashë edhe në fjalën hyrëse që KLGJ-ja, KLP-ja dhe Këshilli i Emërimeve janë krijuar. Ato veprojnë në bazë të ligjeve që ne kemi miratuar. Qoftë Këshilli i Legjislacionit, qoftë Komisioni i Ligjeve, por kam përshtypjen ky i fundit, kur diskutohet nën për nën mbasi të dy ekspertët të kenë draftuar projektligjet, do të merret patjetër mendimi i tyre. Do të bëjmë një seancë dëgjimore edhe me ta, pasi janë ata që do të punojnë me këto ligje dhe kjo është e domosdoshme për t'u bërë. Mendimi i tyre është i domosdoshëm dhe ta lëmë të hapur që qoftë Këshilli i Legjislacionit, qoftë Komisioni i Ligjeve do ta bëjë një gjë të tillë.

Faleminderit!

Fjala për zonjën Dhimitri!

Fatjona Dhimitri - Faleminderit, zoti Fino!

Meqenëse përbërja e Këshillit të Legjislacionit sapo është konstituuar nga pala jonë, kërkojmë më shumë kohë për shqyrtimin e projektligjeve.

Së dyti, relatore për këto projektligje do të jetë Fatjona Dhimitri.

Ndërkohë, kërkojmë kohë për përcaktimin e ekspertit.

Faleminderit!

Bashkim Fino – Fjalën e ka zonja Bushka!

Klotilda Bushka - Faleminderit, zoti kryetar!

Mirë se erdhët, kolege të reja në këtë këshill!

Unë doja të shtoja, përveç atyre që thanë kolegët, faktin që reflektimi i ndryshimeve ligjore në të 2 ligjet që po diskutojmë, është kryer deri tani, në saj të një pune që kanë bërë ekspertët e mëparshëm të komisionit së bashku me misionin EURALIUS. Dua ta theksoj këtë, sepse jemi duke diskutuar për ndryshimin apo për plotësimin me dispozita ligjore të dy ligjeve, që i përkasin reformës në drejtësi, të cilat që kur janë hartuar dhe janë miratuar (para shqyrtimit në Gjykatën Kushtetuese) si pjesë e paketës së reformës në drejtësi kanë qenë ligje të punuara së bashku me misionin EURALIUS. Pavarësisht faktit se secili nga krahët

politikë do të ketë ekspertët e vet, misioni EURALIUS është në këtë proces, sepse edhe materialet paraprake që janë sjellë, janë bërë në konsultim të ekspertëve me misionin EURALIUS. Kjo është pjesë e detyrimit që Kuvendi ka, në kuadër të reformës në drejtësi.

Dëgjesat e tjera, nëse do të çmohet e arsyeshme apo diskutimet nga grupet e interesit, sepse tashmë jemi në një moment kur edhe reforma i ka filluar të zbatohet dhe po i jep frytet e vedeta, unë mendoj që mund të jenë pjesë e diskutimeve tona për të kaluar në Komisionin e Ligjeve jo vetëm se mund të jenë shumë dëgjesa që do të bëhen dhe puna e këtij komisioni duhet të mbarojë sa më shpejt (sigurisht, pa e rënduar cilësinë e procesit), por Komisioni i Ligjeve ka një përbërje më të gjerë me deputetë, gjë që do të thotë se pjesa e shqyrtimit do të jetë në një farë mënyre në vendimmarrjen e më shumë aktorëve politikë brenda Kuvendit. Kështu, në këtë këshill duhet të punojnë ngushtësisht ekspertët me njëritjetrit, po ashtu relatorët dhe anëtarët e tij, me misionin EURALIUS. Pjesën e dëgjesave dhe të konsultimeve mendoj ta diskutojmë së bashku për t'ia lënë si objekt veprimtarie Komisionit të Ligjeve, por kjo është një çështje që mund të vendoset edhe më vonë.

Faleminderit!

Bashkim Fino – Ka njeri tjetër për të folur?

Nëse nuk ka njeri tjetër për të folur unë mendoj që ne sot, pasi miratuam procesverbalin e mbledhjes së kaluar, si dhe dy relatorët (zonjën Klotilda Bushka dhe zonjën Fatjona Dhimitri), shumë shpejt opozita do të na sjellë me shkresë ekspertin përkatës. Eksperti ynë është prezent këtu së bashku me ekspertët e misionit EURALIUS. Të tre ekspertët t'i rishikojnë edhe një herë të 2 projektligjet. Tashmë kemi një draft të përgatitur edhe nga ekspertët e mëparshëm, por po i quaj nul ato në rastin konkret, se do t'i rishikojmë edhe një herë.

Shpresojmë që edhe ju t'i lexoni, por edhe ekspertë tuaj t'ju vënë në dijeni për të gjitha mendimet dhe sugjerimet, që do të trajtohen dhe do të paraqesin këtu, në Këshillin e Legjislacionit për të pasur një draft përfundimtar këtu dhe për të vijuar më tej me procedurën e dëgjesave të KLGJ-së, të KLP-së dhe të Këshillit të Emërimeve, që të kalojnë më tej në Komisionin e Ligjeve për t'u miratuar.

A jemi dakord kështu?

Pra, sot miratuam relatorët, ekspertin në parim (emrin e tij do ta sillni ju brenda 2-3 ditëve). Ekspertët duhet të fillojnë menjëherë nga puna sapo ta paraqisni zyrtarisht ekspertin ai do të fillojë menjëherë nga puna bashkë me ekspertët e EURALIUS-it. Në momentin që ata janë gati, edhe ne si Këshill i Legjislacionit do të jemi të hapur për të thirrur mbledhjen e radhës për t'i shqyrtuar 2 draftet.

A jemi dakord kështu?

Shumë faleminderit!

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA